



## BASHKIA SELENICË

### SHTEGU UJVARES RASALIT

#### RAPORT TEKNIK

Punoi: Ing. Klevis BEDINAJ

Ark. Tea HAXHIAJ

Ark. Fatjon DEVOLLAJ

Ark. Sara BREGU

Ark. Katerina TRALO

Ark. Olta HASIMAJ

Miratoi  
Kryetari  
Nertil BELLAJ



SELENICË 2024

## SHTEGU UJVARËS RASALIT

### Përbajtja:

1. Hyrje
2. Qëllimi i Projekt – Studimit
3. Të përgjithëshme
4. Pozicioni dhe vendodhja e projektit
5. Objektivat
6. Rezultatet e pritshme
7. Gjendja ekzistuese dhe analiza e zgjidhjes së propozuar
8. Zgjidhja e propozuar
9. Kushtet Hidrologjike
10. Organizimi i Punimeve
11. Dokumentacion fotografik

## 1 HYRJE

### 1.1 Qëllimi i zbatimit te projektit

Qëllimi i projektit ‘Shtegu Ujvarës Rasalit’ është zhvillimi i infrastrukturës turistike në fshatin Velçë, duke shfrytëzuar natyrën unike dhe bukuritë e ujëvarës së Rasalit. Synojmë të krijojmë një destinacion tërheqës për turistët, duke përmirësuar eksperiencën e vizitorëve dhe promovuar turizmin e qëndrueshëm në këtë zonë. Ngritja e sinjalistikës turistike, pajisja për aktivitet (HIKING), ndërtimi ballkonit panoramik dhe pishine natyrale me ujin e Ujëvarës së Rasalit, synon jo vetëm të rrisë numrin e vizitorëve në Velçë, por edhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të komunitetit lokal, duke krijuar mundësi punësimi dhe promovuar ruajtjen e mjedisit natyror.

### 1.2 Të përgjithëshme

Bashkia Selenicë pas ngritjes së grupit të punës ka arritur rezultatet si më poshtë:

- Në fazën e parë u hartua propozimi alternativ në lidhje me studimin e detajuar të projektit duke evidentuar të gjitha problematikat që paraqet terreni.
- Janë kryer biseda me banorët në lidhje me ndërhyrjet në zonë dhe rruget më problematike e prioritare.
- Vazhdimësia me hartimin e projekt-preventivit sipas problematikave të hasura.


### 1.3 Pozicioni dhe Vendodhja e Projektit

‘Ujëvara Rasalit’ dhe ‘Ujëvara Shpella e Lopëve’ ndodhen në Fshatin Velçë të Bashkisë Selenicë. Këto ujëvara janë një destinacion që nuk mund të arrihet nga të gjithë vizitorët, aktualisht, pasi shtegu që të çon aty është tejet i vështirë për tu kaluar dhe aspak i sigurt për kalimtarët. Duke qenë se Bashkia Selenicë është një ndër Bashkitë me siperfaqen më të madhe dhe shtrihet përgjithësisht në fshatra, kjo e bënë të ketë atraksione turistike të pazbuluara. ‘Ujëvara Rasalit’ dhe ‘Ujëvara Shpella e Lopëve’ janë ndër mrekullitë që ndodhen në këtë bashki, lehtësish e aksesueshme nga ‘Ruga e Lumit të Vlorës’. Si një bashki e cila kerkonë të rris turizmin në zonë, por me kapacitete ekonomike të pamjaftueshme lind nevoja e përgatitjes dhe aplikimit të këtij projekti.



## SHTEGU UJVARËS RASALIT

VELCE-UJEVARA E RASALIT



## 2 OBJEKTIVAT

### 2.1 Qëllimi dhe rezultatet e pritshme

Objktivi kryesor i këtij projekti është kthimi në një pikë turistike të aksesueshme, duke përmirësuar sinjalistikën për ta bërë të arritshme edhe nga individët të cilët nuk e njohin zonën, por dëshirojnë ta vizitojnë.

Ngritura e Sinjalistikës Turistike: Krijimi i një rrjeti të qartë dhe informues sinjalistik, që do të udhëzojë turistët nëpër rrugët e hiking-ut dhe do të ofrojë informacione mbi atrakcionet natyrore dhe kulturore të zonës.

Pajisja për Aktivitetin Hiking: Ofrimi i mundësive për të eksploruar peisazhet mahnitëse përmes hiking-ut, duke siguruar pajisje të nevojshme për turistët dhe organizimin e ekskursioneve guiduar.

Ndërtimi i Ballkonit Panoramik: Krijimi i një ballkoni me pamje të jashtëzakonshme dhe peisazhin përreth, që do t'i japë mundësinë vizitorëve të shijojnë bukuritë natyrore në një ambient të sigurt dhe komod.

Pishina Natyrale me Ujin e Ujëvarës: Kjo do të ofrojë një eksperiencë relaksuese dhe unike përvizitorët, duke iu lejuar atyre të ndihen më afér natyrës dhe të shijojnë freskinë e ujit të pastër të ujëvarës.

Rezultatet që do të arrihen janë si në vijim:

- Projekti ka prioritet të tij rritjen e turizmit me qëllim rritjen e ekonomisë së kësaj zone dhe zhvillimin e bizneseve që kjo zonë ka. Duke sjellë turistë në këtë zonë bënë të mundur që produktet që prodhohen aty të përdoren po aty, duke lehtësuar punën dhe ndikuar në rritjen ekonomike të këtyre banorëve.

## 3 GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT DHE ANALIZA E ZGJIDHJES

Gjendja ekzistuese e shtegut turistik përrthi ujëvarës së Rasalit dhe fshatin Velçë mund të përshkruhet në disa aspekte:

Shtegu aktual është i paasfaltuar dhe me kushte të ndryshueshme, që e bën atë të vështirë përtu naviguar, veçanërisht gjatë stinëve të lagështa. Mungesa e sinjalistikës është gjithashtu një sfidë, duke penguar turistët në orientim dhe eksplorim.

Siguria: Ndërsa shtegu ofron pamje të mahnitshme, mund të ketë vende me rrezik potencial, si shkëmbinj të rrezikshëm ose zona të ngushta. Kjo e bën të domosdoshme vendosjen e masave të sigurisë dhe sinjalistikës përtë informuar vizitorët.

Interesi Turistik: Ndërsa ka një interes në rritje përturizmin në këtë zonë, mungesa e një infrastrukturë të mirë zhvilluar mund të jetë një pengesë përtërheqjen e më shumë vizitorëve.

Përmirësimi i këtyre aspekteve do të ndihmojë në krijimin e një përvoje më të mirë përturistët dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

## **SHTEGU UJVARËS RASALIT**

Grupi i punës organizoi vizitat në terren për investigimin e gjendjes fizike të shtegut në fjalë, për të cilat nga autoriteti kontraktor jane dhene detajet per nderhyrjet bazuar ne vizatimet per secilen zone ku do te nderhyet.

Detyrat e autoritetit kontraktor jane:

Subjekti i cili do te kryej punen do te kete një bashkepunim te ngushte me stafin e Bashkise, i cili do te kete ne perberje specialist te fushes.

Vetem pas perbatjes se terrenit nga Bashkia do te njoftohet subjekti per te kryer punen per te cilin eshte ngarkuar te veproj.

Bashkepunimi ndermjet stafit te Bashkise dhe Subjektit zbatues do te kryet nepermjet shkesave zyrtare dhe email-e te ndersjellta.